



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti II-të, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL". e datës 02.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti II-të, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK -së, të datës 02.09.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 02.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL", me datë 02.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti II-të, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Ju keni prezantuar vetëm një referenë perderisa në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për kontratë është kërkuar që për secilin lot veq e veq të prezantohet së paku një referencë.
- Nuk ju kemi kërkuar dokumente shtesë me nenin 72, të LPPsë, sepse çmimi i juaj ka qenë më i lartë se i operatorit ekonomik fitues i cili ka qenë i përgjegjshëm;
- Sa i përket prodhuesit gabimisht është cekur se nuk i keni furnizimet e prodhuesit evropian.

Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupit të operatorëve ekonomik "PRO MEDICAL" sh.p.k. & Adnan A.Bala B.I. është me çmimin më të ulët, prandaj Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

